

**PROJEKT STATUTI I PROPOZUAR PËR MIRATIM I  
SHOQERISË BUKA SH.A.**

**NË MBLEDHJEN E ASAMBLESE SË AKSIONARËVE  
TË DATËS 16 SHTATOR 2015 ORA 11.00  
NË SELINË E SHOQËRISË BUKA SH.A.**

**(PËR TU KONSULTUAR NGA AKSIONARËT E SHOQËRISË)**

# STATUTI I SHOQËRISË AKSIONARE

## BUKA SH.A.

(Sistemi me një Nivel)

### TITULLI I EMRI I SHOQËRISË – SELIA E REGJISTRUAR – KOHËZGJATJA

#### **Neni 1 – Emri i Shoqërisë**

- 1.1 Shoqëria e emërtuar **BUKA Sh.a.** (në vijim referuar si “**Shoqëria**”) është një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit no. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, i ndryshuar (“referuar këtu e më poshtë si “**Ligji Tregtar**”).
- 1.2 Shoqëria ka vulën zyrtare dhe logon e saj.

#### **Neni 2 – Selia Ligjore**

- 2.1 Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: BUKA sh.a., Rr. Kavajes, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Shoqëria mund të hapë apo të mbyllë filiale, degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe/ose jashtë saj.
- 2.3 Në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet Shoqërisë dhe aksionarëve, adresa për shkak të detyrës të çdo aksionari, do të jetë adresa që përcaktohet në regjistrin e aksionarëve të Shoqërisë. Në rast ndryshimi të kësaj adrese, aksionari përkatës do të njoftojë menjëherë me shkrim Shoqërinë dhe ndryshimi do të pasqyrohet në regjistrin e aksionarëve të Shoqërisë.

#### **Neni 3 – Kohëzgjatja**

- 3.1 Shoqëria është krijuar për një afat të pacaktuar.

### TITULLI II OBJEKTI

#### **Neni 4 - Objekti**

- 4.1 Objekti i Shoqërisë, do të përfshijë, por, nuk kufizohet në aktivitetet e mëposhtme:

Shfrytëzimi i aseteve dhe pasurive të paluajtshme të Shoqërisë; dhënia e tyre me qera në palë të treta; përdorimi për nevoja të veta të depove, magazinave, ndërtesave; apo dhënia me qera e tyre palëve të treta;

Magazinimi i produkteve të ndryshme në ndërtesat dhe asetet e Shoqërisë për nevojat e veta; apo me qera në favor të palëve të treta;

Tregëtia me shumicë dhe/ose e pakicë e të gjitha mallrave të të gjitha llojeve;

Aktivitet Import dhe/ose Eksport të mallrave dhe të mirave materiale të të gjitha llojeve;

Aktivitet ndërtimi dhe konstruksioni i godinave rezidenciale, qendrave tregëtare, dhe strukturave të ndryshme;

Aktiviteti i manaxhimit, shitjes, dhënies me qera, administrimit për nevoja të Shoqërisë apo në favor të të tretëve të pasurive të paluajtshme, apo tyre të luajtshme;

Aktiviteti i konsulencës në fushën e pasurive të paluajtshme;

Konsulencë dhe aktivitet tregëtar në fushën e arkitekturës, inxhinierisë së ndërtimit;

Aktivitete bar-restorant-klub-klub nate; etj dhe tregëtimi i të gjitha produkteve ushqimore, gatimeve, pijeve të të gjitha llojeve, pa u kufizuar në pije alkoolike, etj. Prodhimi i produkteve ushqimore dhe pijeve pa kufizim; tregëtimi, manaxhimi dhe administrimi i kësaj industrie;

Organizimi, manaxhimi dhe administrimi i industrive zbavitëse të të gjitha llojeve dhe për të gjitha moshat dhe shtresat, pa kufizime;

Organizimi i të gjitha aktiviteteve kreative dhe zbavitëse për të gjitha moshat dhe shtresat; organizimi, manaxhimi dhe administrimi i aktiviteteve artistike dhe kulturore;

Prodhimin, shitjen me shumicë apo pakicë të bukës, të të gjitha llojeve, të majasë së bukës, dhe produkteve të tjera të ngjashme nga përpunimi i miellit;

Të gjitha dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

4.2 Me qëllim përmbushjen e objektit të lartpërmendur, Shoqëria gjithashtu, mund të:

- (a) kryejë çdo aktivitet me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme si edhe aktivitete tregtare, financiare, qera apo hipotekore të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë;
- (b) blejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, interesa në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj; të marrë kredi/hua nga institucione financiare të licensuara në Shqipëri apo jashtë saj; dhe
- (c) të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë.

4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili nuk ndalohet nga ligji i zbatueshëm.

TITULLI III  
KAPITALI AKSIONAR – AKSIONET – TRANSFERIMI

**Neni 5 – Kapitali aksionar**

- 5.1 Kapitali aksionar i nënshkruar i Shoqërisë është 239,000,000.00 (dyqind e tridhjetë e nëntë milionë) Lekë, i ndarë në 283,104.00 (dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e katër) aksione të zakonshme me vlerë nominale 844.21 (tetë mijë e katërqind e dyzet e katër pike njëzet e një) Lekë secili.
- 5.2 Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga Aksionarët që zotërojnë aksionet e kapitalit të Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë zmadhimin e kapitalit aksionar me anë të emetimit të aksioneve të reja, zmadhimit të kufizuar të kapitalit aksionar, zmadhimit të autorizuar të kapitalit aksionar, kalimit në kapitalin bazë të rezervave të disponueshme dhe të fitimeve të pashpërndara, emetimit të obligacioneve të konvertueshme dhe rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese.
- 5.3 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin aksionar të Shoqërisë nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve, zvogëlimit të thjeshtëzuar të kapitalit aksionar, apo anulimit të aksioneve por në asnjë rast kapitali aksionar nuk mund të jetë më i vogël se kapitali i regjistruar i shoqërisë.

**Neni 6 – Aksionet**

- 6.1 Aksionet janë të zakonshme.
- 6.2 Akti i emetimit të aksioneve hartohet në çastin e emetimit fillestar të aksioneve dhe ky akt përmban të dhënat dhe duhet të jetë në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin e zbatueshëm.
- 6.3 Çdo aksion jep të drejtën e një vote.
- 6.4 Administratori i Shoqërië harton dhe mban regjistrin e aksionarëve të Shoqërisë në selinë e regjistruar të Shoqërisë i cili duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin apo emrin e shoqërisë, numrin e aksioneve, vlerën nominale të aksionit, adresën për shkak të detyrës apo adresën zyrtare të aksionarit.

**Neni 7 – Transferimi i Aksioneve**

- 7.1 Aksionet e Shoqërisë mund të transferohen lirisht tek palë të treta, tërësisht apo pjesërisht, nga secili prej aksionarëve të Shoqërisë, pa qene i nevojshëm njoftimi, apo mbledhja e aksionarëve.

- 7.2 Çdo transferim i së drejtës së pronësisë lidhur me aksionet e Shoqërisë si edhe krijimi apo transferimi i çdo të drejte tjetër lidhur me këto do të regjistrohet në regjistrin e aksionarëve. Transferuesi do të njoftojë me shkrim Administratorin e Shoqërisë në lidhje me transferimin në ditën efektive të këtij transferimi.

TITULLI IV  
SEKSIONI I  
ORGANET E SHOQËRISË

**Neni 8 – Organet e Shoqërisë**

Organet e Shoqërisë janë:

- 1) Asambleja e Përgjithshme;
- 2) Këshilli i Administrimit;
- 3) Administratori/ët; dhe
- 4) Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar.

SEKSIONI II  
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

**Neni 9 – Asambleja e Përgjithshme**

- 9.1 Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e cila përbëhet nga Aksionarët e Shoqërisë.
- 9.2 Çdo aksionar ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme për të shprehur mendimin e tij dhe për të votuar në proporcion me aksionet që ai zotëron.
- 9.3 Aksionari nuk mund të lëshojë prokurë për të votuar për një pjesë të aksioneve të tij kur voton personalisht për pjesën tjetër të aksioneve të tij.
- 9.4 Asambleja e Përgjithshme mund të mbahet në një vend tjetër nga selia e regjistruar e shoqërisë, brenda Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Këshilli i Administrimit apo Administratori në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar, apo nga një aksionar apo aksionarë të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit aksionar, apo nga çdo person tjetër i autorizuar sipas ligjit të zbatueshëm. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme do të thirret të paktën një herë në vit, jo më vonë se muaji qershor i çdo viti me qëllim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit financiar të mëparshëm.

- 9.6 Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme u njoftohet aksionarëve në përputhje me këtë Statut.
- 9.7 Administratorët u përgjigjen me shkrim, çdo kërkesë me shkrim përfshirë komunikimin elektronik, për sqarim për rendin e ditës, dërguar nga aksionarët, që përfaqësojnë jo më pak se 5% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, kërkesë kjo e dërguar jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme. Çdo kërkesë për sqarim, apo për informacion në kuadër të rendit të ditës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet dërguar nga aksionarët nëpërmjet postës së regjistruar në selinë e Shoqërisë, apo nëpërmjet postës elektronike, në adresën postare elektronike të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat e nenit 139 të Ligjit Tregëtar. Kërkesa mes të tjerave duhet të përmbajë edhe adresën e saktë të aksionarit, me qëllim kthimin e përgjigjes nga Administratorët e Shoqërisë.
- 9.8 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme u njoftohet aksionarëve, në përputhje me afatet minimale të përcaktuara në Ligjin Tregëtar, nëpërmjet botimit të thirrjes dhe informacioneve në një gazetë të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin, në përputhje me nenin 137, pika 4 të Ligjit Tregëtar. Në këtë rast, informacionet në kuadër të rendit të ditës së mbledhjes mund të merren përgjatë afatit të botimit në selinë zyrtare të Shoqërisë, dhe këto informacione publikohen edhe në faqen zyrtare në internet të Shoqërisë, me qëllim konsultimin nga aksionarët e Shoqërisë.
- 9.9 Vendimet e Asamblesë mund të jenë edhe të formës qarkulluese, përsa kohë janë respektuar të gjitha kërkesat e thirrjes së saj sipas Ligjit Tregëtar.
- 9.10 Nje aksionar mund të përfaqësohet në Asamblesën e Përgjithshme, në bazë të një prokure, nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila mund të përfshijë mbledhjet vijuese, por vetëm për të njëjtin rend dite.

#### **Neni 10 – Kuorumi dhe Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

- 10.1 Vendimet e zakonshme merren me votën pro të aksionarëve, që përfaqësojnë shumicën e thjeshtë të aksioneve me të drejtë vote në kapitalin e Shoqërisë, që marrin pjesë në mbledhje ("**Shumica e Thjeshtë**"), sipas përcaktimeve dhe në përputhje me Nenin 145 (2) të Ligjit Tregëtar.
- 10.2 Asambleja e Përgjithshme merr vendime me Shumicë të Thjeshtë, sipas Nenit 10.1 më sipër, lidhur me çështjet e mëposhtme:
- (a) përcaktimin e politikave tregtare të përgjithshme të Shoqërisë;
  - (b) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit;
  - (c) emërimin dhe shkarkimin e ekspertit/ve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve;

- (d) përcaktimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat (b) dhe (c);
  - (e) miratimin dhe zbatimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të bilancit e të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - (f) ndryshim i datës referuese kontabël apo politikave kontabël;
  - (g) miratimin e rregullave proceduriale të Mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
  - (h) çdo çështje tjetër që përcaktohet nga ligji i zbatueshëm dhe nga ky Statut.
- 10.3 Në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicë të cilësuar, këto do të merren me votën pro të aksionarëve, që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e aksioneve me të drejtë vote të Shoqërisë, që marrin pjesë në mbledhje (“**Shumica e Cilësuar**”), sipas parashikimeve dhe në përputhje me Nenin 145 (1) të Ligjit Tregtar.
- 10.4 Asambleja e Përgjithshme merr vendime me Shumicë të Cilësuar, në kuptimin e Nenit 10.3 sa më sipër, për çështjet e mëposhtme:
- (a) ndryshime apo shtesa të Statutit të Shoqërisë;
  - (b) zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
  - (c) shpërndarja e fitimeve vjetore;
  - (d) riorganizimin, apo prishjen e Shoqërisë;
- 10.5. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme dhe me vendime qarkulluese që komunikohen me postë të regjistruar apo korier si edhe me Faks të cilët duhet të nënshkruhen nga aksionari (t) apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar.

### SEKSIONI III KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

#### **Neni 11 – Këshilli i Administrimit**

- 11.1 Këshilli i Administrimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, me shumicë të thjeshtë votash të aksionarëve që marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë, në përputhje me nenin 145 të Ligjit Tregtar.
- 11.2 Anëtarët e Këshillit të Administrimit emërohen për një afat prej 3 (tre) vjetësh dhe mund të ri-zgjidhen. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë në çdo moment Anëtarët e Këshillit të Administrimit.
- 11.3 Asambleja e Përgjithshme emëron Kryetarin e Këshillit të Administrimit midis anëtarëve të tij i cili ka gjithashtu të drejtën e një vote shtesë.
- 11.5 Administratori i Shoqërisë emërohet më shumicë të thjeshtë nga anëtarët e Këshillit të Administrimit.

## **Neni 12 – Mbledhjet e Këshillit të Administrimit**

- 12.1 Këshilli i Administrimit do të mbledhet sa herë kërkohet për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Kryetari i Këshillit të Administrimit mund të thërrasë mbledhjen e Këshillit të Administrimit në çdo kohë, me kusht që, anëtarët e Këshillit të Administrimit të marrin njoftim të paktën 72 (shtatëdhjetë e dy) orë përpara çdo Mbledhje të Këshillit të Administrimit apo çdo anëtar të heqë dorë me shkrim nga njoftimi i mbledhjes. Kërkesa, duhet të përmbajë, rendin e ditës. Çdo mbledhje mund të mbahet me praninë personalisht të anëtarëve, apo me telekonferencë apo me mjete të ngjashme komunikimi, me kusht që, të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje të dëgjojnë njëri-tjetrin dhe Kryetari i Këshillit të Administrimit të nënshkruajë rregullisht procesverbalin. Njoftimet për mbledhjen e Këshillit të Administrimit, dërgohen për anëtarët nëpërmjet postës elektronike (*e-mail*).
- 12.2 Këshilli i Administrimit mund të caktojë një sekretar për mbajtjen e procesverbalit. Sekretari mund të jetë anëtar apo jo anëtar i Këshillit të Administrimit.
- 12.3 Mbledhjet e Këshillit të Administrimit thirren rregullisht kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij, me kusht që, në mbledhje të jetë i pranishëm Kryetari i saj.
- 12.4 Megjithatë, Këshilli i Administrimit merr vendime qarkulluese me shkrim, apo në formë elektronike nëpërmjet postës elektronike, pa qënë e nevojshme thirrja paraprake e saj, apo mbajtja e një mbledhje, me kusht që, ky akt të nënshkruhet në mënyrë të rregullt, nga të gjithë anëtarët e tij.
- 12.5 Këshilli i Administrimit merr vendime të vlefshme me votën pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
- 12.6 Mbledhjet e Këshillit të Administrimit do të zhvillohen në gjuhën shqipe dhe çdo material me shkrim që do të diskutohet në këtë mbledhje do të jetë në shqip. Vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve do të përgatiten menjëherë pas çdo mbledhje dhe do të nënshkruhen nga Kryetari.

## **Neni 13 – Kompetencat e Këshillit të Administrimit**

- 13.1 Këshilli i Administrimit ka të gjitha kompetencat lidhur me mbikqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë të Administratorit si edhe kryerjen e aktivitetit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë nga ky i fundit, përveç atyre kompetencave që sipas këtij Statuti, Marrëveshjes së Aksionarëve apo ligjit të zbatueshëm iu rezervohen organeve të tjera.
- 13.2 Përveç, detyrimeve ligjore dhe përgjegjësiive sipas Ligjit Tregtar, Këshilli i Administrimit ka kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:



- (a) kontrolli dhe mbikqyrja e drejtimit të Shoqërisë, dhe miratimi dhe zbatimi i politikave tregtare të detajuara për Shoqërinë në përputhje me Aktivitetet e përcaktuara në nenin 4 të këtij Statuti, plan biznesit të Shoqërisë, nga Administratorët e Shoqërisë;
- (b) me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, merr masa për përgatitjen e drafteve të nevojshëm dhe draft vendimeve që janë kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme dhe jep rekomandime;
- (c) miratimi i organogramës së Shoqërisë, përgatitur nga Administratori/ët e Shoqërisë;
- (d) miraton financime, kredi, over-drafte nga palë të treta, apo në favor të të tretëve sipas raporteve të paraqitura nga Administratori i Shoqërisë;
- (e) miraton marrëveshje me të tretë dhe/ose pagesa të caktuara, të dërguara për mendim dhe miratim nga Administratori i Shoqërisë;
- (f) Miraton në bazë të sugjerimeve dhe raporteve të Administratorit të Shoqërisë konsulentët e Shoqërisë në lidhje me çështjet ligjore, ato fiskale, çështjet administrative dhe përfaqësimet në gjykata apo arbitrazhe.
- (g) thërret Asamblenë e Përgjithshme sa herë e quan të nevojshme;
- (h) emëron dhe shkarkon në diskrecion e saj dhe në çdo moment Administratorët e Shoqërisë dhe cakton shpërblimet e tyre.

#### SEKSIONI IV ADMINISTRATORI/ËT

##### **Neni 14 – Administratori Kompetencat e Administratorit të Shoqërisë**

- 14.1 Administratori (“**Administratorët e Shoqërisë**”, “**Administrator/ët**”) është person fizik, i cili mund të jetë ose jo anëtar i Këshillit të Administrimit, dhe propozohet dhe emërohet nga Këshilli i Administrimit, në përputhje me Nenin 158 të Ligjit Tregtar. Këshilli i Administrimit, apo aksionarët nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme, dhe me diskrecionin e tyre të plotë mund të shkarkojnë në çdo kohë Administratorin/ët për çfarëdolloj shkak që këto e quajnë të arsyeshëm.
- 14.2 Administratori ka të gjitha kompetencat të kryejë veprime në lidhje me administrimin e zakonshëm të shoqërisë të cilat janë të nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë përveç kompetencave që u rezervohen organeve të tjera sipas këtij statuti dhe ligjit të zbatueshëm. Këto kompetenca dhe veprime janë të vlefshme dhe detyruese vetëm me nënshkrimin e Administratorit.
- 14.3 Administratori i Shoqërisë duhet t’i raportojë Këshillit të Administrimit në çdo kohë kur kërkohet dhe në rast të kundërt shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Administrimit.
- 14.4 Në rast se Administratori ka një interes apo atë të një pale të tretë në një transaksion/veprim të caktuar të Shoqërisë, ai do të njoftojë paraprakisht me

shkrim Këshillin e Administrimit dhe aksionarët ku do të specifikojnë llojin, objektin, kushtet, origjinën dhe shkallën e interesit në transaksion/ veprimin e caktuar. Administratori nuk mund të kryejë veprimin në fjalë pa autorizimin paraprak me shkrim të Këshillit të Administrimit. Administratori ka përgjegjësi përkundrejt aksionarëve të Shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim të Shoqërisë dhe administrimin e kryer nga këta si edhe për çdo dëm që i shkaktohet Shoqërisë si pasojë e veprimeve të tyre apo mosveprimeve të lartpërmendura.

- 14.5 Si rregull, Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të tretëve, dhe firmos në emër të Shoqërisë, përveç rasteve, të shprehura ndryshe në këtë Statut apo në Ligjin Tregëtar. Administratori është përgjegjës për hapjen apo mbylljen e llogarive bankare të Shoqërisë; ai firmos marrëveshjet dhe kontratat në emër të Shoqërisë; kryen pagesat kundrejt të tretëve, dhe përfaqëson Shoqërinë përpara institucioneve dhe enteve publike, apo atyre private; Administratori firmos në emër të Shoqërisë.
- 14.6 Administratori në konsultim me Këshillin e Administrimit, dhe me ndihmën e konsulentëve të Shoqërisë përgatit plan-biznesin vjetor, apo disa vjeçar të Shoqërisë, dhe draftin e politikave tregëtare të Shoqërisë, në përputhje me politikat e përgjithshme tregëtare të Shoqërisë, dhe Objektin të Aktiviteteve (Neni 4) të Shoqërisë në këtë Statut.
- 14.7 Administratori përgatit organogramën dhe strukturën e punonjësve dhe/ose ofruesve të tjerë të shërbimeve të Shoqërisë, dhe ia përcjell për miratim Këshillit të Administrimit të Shoqërisë.
- 14.8 Përgatit raporte financiare dhe teknike, në lidhje me çështje të caktuara në veprimtarinë e përditshme tregëtare të Shoqërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në përgatitjen e raporteve dhe informacionit në lidhje me marrëveshje, kredi, financime, over-drafte, nga ose për të tretët, dhe ia dorëzon këto për miratim Këshillit të Administrimit.
- 14.9 Paraqet për mendim dhe miratim Këshillit të Administrimit, marrëveshje me të tretë dhe/ose pagesa të caktuara.
- 14.10 Kryen regjistrimet dhe aplikimet e nevojshme për nevojat e përditshme të Shoqërisë pranë enteve dhe institucioneve publike, në përputhje me të gjitha kërkesat e ligjit Shqiptar, dhe kujdeset për afatet dhe kërkesat e tjera të ligjit në lidhje me këto regjistrime.
- 14.11 Raporton dhe i jep informacion Këshillit të Administrimit në lidhje me të gjitha çështjet që mund të afektojnë pozitivisht apo negativisht ecurinë e aktivitetit tregëtar të Shoqërisë.

- 14.12 Sugjeron dhe shtron per miratim përpara Këshillit të Administrimit konsulentët e Shoqërisë në lidhje me çështjet ligjore, ato fiskale, çështjet administrative dhe përfaqësimet në gjykata apo arbitrazhe.
- 14.13 Mban në mënyrë të rregullt dhe përditëson librin e aksioneve të Shoqërisë, procesverbalet dhe vendimet e mbledhjeve të Asamblesë së Aksionarëve dhe të Këshillit të Administrimit.
- 14.14 Mban në mënyrë të saktë dhe të rregullt dokumentat dhe librat kontabël të Shoqërisë;
- 14.15 Mbron interesat e Shoqërisë dhe të aksionarëve të Shoqërisë dhe zbaton në mënyrë rigoroze parimin e besnikërisë, dhe parimet më të larta të etikës.

SEKSIONI V  
EKSPERTI/T KONTABËL TË AUTORIZUAR

**Neni 15 – Eksperti/t Kontabël të Autorizuar**

- 15.1 Kontrolli i brëndshëm i Shoqërisë kryhet nga një apo më shumë ekspertë kontabël të autorizuar të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme për një afat të caktuar.

SEKSIONI V  
VITI FINANCIAR, FITIMET

**Neni 16 – Viti Financiar**

- 16.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më datë 31 dhjetor të çdo viti.

**Neni 17 – Fitimet**

- 17.1 Asambleja e Përgjithshme me shumicë të cilësuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar dhe me këtë Statut, mund të vendosë në lidhje me fitimet që rezultojnë nga bilanci, pas zbritjes së rezervës ligjore dhe të gjithë shumave që Asambleja e Përgjithshme vendos si rezervë.
- 17.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për krijimin e rezervave të jashtëzakonshme apo të veçanta.

SEKSIONI VI  
PRISHJA – SHPËRBËRJA-BASHKIMI, LIKUIDIMI

**Neni 18 – Prishja- Shpërbërja- Bashkimi**

- 18.1 Shoqëria prishet në rastet e parashikuara në ligjin e zbatueshëm. Në rast prishje, Asambleja e Përgjithshme emëron një apo më shumë likuidues dhe u delegon këtyre kompetencat e duhura.
- 18.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të shpërbëhet apo bashkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

### **Neni 19 – Likuidimi**

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për administrimin e kësaj procedure, Asambleja e Përgjithshme emëron një apo më shumë likuidues, i cili do të përgatisë raportin përfundimtar lidhur me aktivin dhe pasivin e Shoqërisë si dhe për procedurat e likuidimit e kohën e nevojshme për likuidimin.
- 19.3 Pas përfundimit të procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do të marrë vendim për bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesi/t dhe përfundimin e procedurës së likuidimit.

### **SEKSIONI VII TË NDRYSHME**

### **Neni 20 – Gjuha**

- 20.1 Ky Statut është hartuar në gjuhën shqipe.

### **Neni 21 – Ligji i zbatueshëm dhe Juridiksioni**

- 21.1 Ky Statut rregullohet nga ligji Shqiptar në fuqi dhe çdo mosmarrëveshje që lind nga dhe në lidhje me këtë Statut do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 21.3 Çdo çështje që nuk rregullohet shprehimisht në këtë Statut dhe në çdo marrëveshjen aksionarësh do të rregullohet nga Ligji Shqiptar Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.

\* \* \* \* \*

**Tiranë, më [\*.].[\*].2015**